

20181632978

LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË DETYRIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E SEGMENTIT RRUGOR KRIVA PALLANKË-DEVE BAIR (KUFIRI ME BULLGARINË), E CILA DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE NËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes për hua për financimin e segmentit rrugor Kriva Pallankë - Deve Bair (kufiri me Bullgarinë), e cila do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore në shumë prej 10.000.000 euro, nëse Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nuk i plotëson dhe nuk i servison detyrimet e Marrëveshjes për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas përcaktohen me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për financimin e segmentit rrugor Kriva Pallankë - Deve Bair (kufiri me Bullgarinë).

Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 4

Afati i pagimit të huas është 15 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej tri vjetësh.
Shkalla e kamatës është variable dhe përbëhet nga EURIBOR gjashtëmujor të rritur për margjinë prej 1%.
Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëfishtë në lartësi prej 1% të shumës së huas.
Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion në lartësi prej 0,5% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rrjedhin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve i kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, të dedikuara për segmentin rrugor Kriva Pallankë - Deve Bair (kufiri me Bullgarinë), i financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtë të zbritjes së tatimit paraprak.
Importi i të mirave/mallrave nga Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore, të dedikuara për segmentin rrugor Kriva Pallankë - Deve Bair (kufiri me Bullgarinë), i financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe taksat importuese, si dhe nga akciza gjatë importit të automjeteve për udhëtarë dhe vajrave minerale.

Për qarkullimin i cili është kryer ndaj Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për qëllimet e segmentit rrugor Kriva Pallankë - Deve Bair (kufiri me Bullgarinë), të financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji, për të cilin i njëjti është debitor tatimor sipas nenit 32 pika 4 dhe nenit 32-a të Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar, lirohet nga detyrimi që ta llogaritë dhe paguajë tatimin mbi vlerën e shtuar.

Tatimpaguesi i cili kryen qarkullim për të cilin është liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të së mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë e thekson edhe emërtimin e projektit dhe emërtimin e Marrëveshjes për hua nga neni 1 të këtij ligji.

Neni 7

Për realizimin e lirit nga neni 6 paragrafi (2) të këtij ligji, Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore parashtron kërkesë në Ministrinë e Financave - Drejtorinë Doganore.

Forma dhe përmbajtja e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni dhe dokumentacioni shoqërues përcaktohet nga ministri i Financave.

Neni 8

Malli i cili është liruar nga pagesa e taksave importuese në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, në afat prej tri vitesh nga dita e importit, nuk guxon të tjetërsohet, t'i jepet për shfrytëzim tjetrit, të huazohet ose përdoret ndryshe për qëllime tjera e jo për ato për të cilat është liruar nga pagesa e taksave importuese, përpara se të paguhen taksat importuese. Sendet e tilla nuk guxojnë të jepen peng, të huazohen ose të jepen si sigurim për detyrime tjera.

Nëse poseduesi i së drejtës, para skadimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, mallin i cili ka qenë i liruar nga pagesa e taksave importuese në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, ka për qëllim ta përdorë për qëllime tjera e jo për ato për të cilat është liruar nga pagimi i taksave importuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor te organi doganor.

Lartësinë e borxhit doganor nga paragrafi 2 i këtij neni, organi doganor e përlllogarit në bazë të elementeve për përcaktimin e taksave në fuqi në momentin e parashtrimit të kërkesës për pagimin e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, lartësia e borxhit doganor përlllogaritet në bazë të elementeve për përcaktimin e taksave në momentin e pranimit të deklaratës doganore në bazë të së cilës malli është liruar nga pagesa e taksave importuese.

Neni 9

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".